



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1157/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina”, SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit SH.A. Kostt el.bartja, me seli në Prishtinë rr”Isa Boletini” nr39, me bazë juridike përmbarimore, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.565/22 të datës 29.06.2023, me datën 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” SH.A. me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.565/22 i datës 29.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.565/22 të datës 29.06.2023, në pikën I të dispozitivit e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit SH.A. Kostt el.bartja, ka Anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor P.nr.89/2020, i datës 27.02.2020, i Përmbaruesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,822.74 € (njëmijë tetëqind e njëzetë e dy euro e shtatëdhjetë e katër cent). Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka Refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit SH.A. Kostt el.bartja dhe ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.89/2020 të datës 27.02.2020, të Përmbaruesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi, sa i përket shumës prej 91.80 € (nëntëdhjetë e një euro e tetëdhjetë cent), dhe në pikën III e ka Përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore e kreditorit “Kompania Rajonale Ujësjiellësi ”Prishtina”, SH.A., ndaj debitorit SH.A. Kostt el.bartja, sipas urdhrit përmbarimor P.nr.89/2020 të datës 27.02.2020, për shumën prej 1,822.74 € (njëmijë tetëqind e njëzetë e dy euro e shtatëdhjetë e katër cent).

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës civile, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj si të bazuar ankesën dhe aktvendimin e kundërshtuar ta prishë dhe çështjen t’ia kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose ta ndryshojë aktvendimin e atakuar.

Përgjigje në ankese nuk ka paraqitur debitori.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina", SH.A., ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.89/2020 të datës 27.02.2020, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.1172, nga data 01.01.2013 deri me datë 27.02.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin SH.A. Kostt el.bartja, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,914.54 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, në të kundërtën përbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirrollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit në TEB Bank, ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përbarimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetimin se shërbimet në fjalë nuk janë shfrytëzuar nga ana e debitorit dhe komunikimet me kreditorin janë bërë në mënyrë të vazhdueshme për të bërë sqarimet e duhura që të arsyetohet mos pagesa e tyre nga KOSTT dhe duke insistuar që pagesat të drejtohen te palët që i kanë pas në shfrytëzim lokalet përkatëse. Ka shtuar se lokalet në kurriz kanë qenë të uzurpuara nga persona të ndryshëm e debitori në asnjë rast nuk ka pasur qasje në këto lokale as për menaxhim e as për monitorim, madje cdo tentim për konstatimin e gjendjes është përcjellë nga kërcënime të të gjitha llojeve. Po ashtu ka theksuar se kërkesa për pagesën e borxhit është parashkruar në bazë të nenit 69 pika 69 pika 1.4 e Ligjit Nr.04/L-139, për Procedurën Përbarimore, nga se ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përbarimi po ashtu edhe në mbështetje të dispozitave ligjore gjegjësisht sipas LMD- së një kërkesë e tillë konsiderohet e parashkruar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përbarimor P.nr.89/20, i datës 27.02.2020, i lëshuar nga përbaruesi privat Emine Sherifi Lubeniqi.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se e kundërshton prapësimin si të pa bazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në ligj dhe në prova. Ka shtuar se e kundërshton pretendimin lidhur me parashkrimin duke u bazuar në nenin 368 të LMD-së në të cilin citohet se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, dhe pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklarin e kreditorit, por edhe në mënyrë të tërthorët sikurse janë pagesa e këstit, pagesa dhënia e sigurimit. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar dhe të pa argumentuar.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.565/22 të datës 29.06.2023 me të cilin e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke vendosur sikur në dispozitiv të aktvendimit. Gjykata pas vlersimit të ekstraktit nga librat afariste për faturat e përfshira në ekstrakt dhe sipas nenit 355 par.1 dhe të LMD-së, ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit është pjesërisht e parashkruar. Kërkesat e kreditorit për faturat nga data 31.12.2013 deri 27.02.2017 në shumën 1,822.74€ janë parashkruar sipas nent 355 të LMD-së, pasi që

propozimi për përmbarrim është paraqitur me datën 27.02.2010 ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit kanë kaluar më tepër se 3 vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë. Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore 28.02.2017 deri me 29.02.2020 gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit referuar nenit 355 të LMD-së në të cilin parashihet afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontrata komerciale. Gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit refuzoi prapësimin e debitorit dhe la në fuqi urdhrin për përmbarrim P.nr.89/20 dt.27.02.2020, për shumën prej 91.80€, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarruesit privat, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm –Ekstraktin nga librat afariste për periudhën 01.01.2013 e deri më 27.02.2020, në bazë të cilës përmbarruesi privat ka zbatuar përmbarrimin, e i cili borxh i kërkuar nga kreditori në bazë të nenit 355 të LMD-së është parashkruar pjesërisht.

Edhe kjo gjykatë ka shqyrtuar shkresat në lëndë dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, mbi çështjen që i referohet parashkrimit të kërkesës së kreditorit dhe vlerëson se dhoma e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur përkitazi parashkrimit të një pjese të detyrimit të debitorit ndaj kreditorit për shumën prej 1,822.74€, e kjo bazuar në faktin se kjo shumë e borxhit rezulton të jetë e periudhës kohore sipas faturave nga data 31.12.2013 deri me datën 27.02.2017, dhe që nga kjo periudhë e deri me paraqitjen e propozimit për përmbarrim datë 27.02.2020 kanë kaluar më tepër se tre vite, prandaj me të drejtë është zbatuar neni 355 par.1 LMD-së, që parasheh që *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, ndërsa par.2 parasheh që *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.*

Gjithashtu Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se dhoma e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur kur ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarrimor P.nr.89/2020 dt.27.02.2020 sa i përket shumën prej 91.80€ i cili borxh i debitorit ndaj kreditorit, i përket periudhës kohore 28.02.2017 deri me datën 29.02.2020, për arsye se me parashtrimin e propozimit për përmbarrim me datën 27.02.2020 nga kreditori, është shkaktuar ndërprerja e afatit të parashkrimit konform nenit 369 të LMD-së.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë i analizoi pretendimet e kreditorit sa i përket pagesave të kësteve mujore, por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete në mbështetje të tyre, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1157/23 me datë 16.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha